



Prishtinë, 27 tetor 2021
Kodi i ZRRE-së: V_1441_2021

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u Bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.7, Neni 15 dhe Nenin 26 par. 1 nënpar. 1.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05 -L-084);
- Nenin 20 të Ligjit për Energjinë Termike (Nr. 05-L-052); dhe
- Kërkesën e ndërmarrjes NQ Termokos SH.A., për Amendamentimin e Marrëveshjes bazë për Furnizim me Ndrohje të datës 15.12.2014, Nr. 252 " të lidhur në mes të KEK Gjenerimi SH.A dhe NQ Termokos SH.A., të dorëzuar për aprovim me datë 11 tetor 2021 në ZRRE,

në seancën e mbajtur me datë 27 tetor 2021, nxori këtë:

VENDIM

- I. **APROVOHET** kërkesa dhe Amandamentohet "Marrëveshja bazë për furnizim me ngrohje e lidhur në mes të KEK-Korporata Energjetike e Kosovës SH.A. dhe NQ Termokos SH.A me datë 15.12.2014, Nr. 252 " dhe e aprovuar nga Bordi i ZRRE-së me Vendimin V_677_2014 të datës 23 dhjetor 2014.
- II. Amendamentimi i Marrëveshjes së bashkangjitur plotësohet dhe ndryshohet si në vijim:
 - Neni 1, me të cilin përcaktohet periudha e vlefshmërisë së Aneks Marrëveshjes – nga data e 15 tetor 2021 deri më 15 prill 2022.
 - Neni 2, me të cilën ndryshohen 2(dy) paragrafë të Shtojcës IV të Marrëveshjes bazë. Ky ndryshim është rrjedhojë e de-rregullimit të gjeneratorit të energjisë elektrike (KEK SH. A). Me konkretisht, çmimet e energjisë termike nga ko-gjenerimi në TC Kosova "B" i referohen çmimit të energjisë elektrike që KEK Gjenerimi i ofron Furnizuesit të Shërbimit Universal të Energjisë Elektrike (FSHU) në vlerën 29.50€/MWh, si dhe koston shtesë prej 0.27 €/MWh për të mbuluar koston e konsumit të energjisë elektrike në Stacionin e ekstraktimit të energjisë termike në TC Kosova "B" (HES), në bazë të Metodologjisë së dakorduar paraprakisht mes KEK SH.A. - NQ Termokos SH.A.- ZRRE-së.
 - Nenin 3, me të cilin palët pajtohen që çmimi bazë i ri-kalkuluar sipas Nenit 2 të jetë 29.77 €/MWh.
 - Nenin 4, me të cilin palët pajtohen që, për periudhën sipas Nenit 1, çmimi i energjisë termike të jetë në nivelin 1.36 €/MWh ndërsa për kapacitetin elektrik të jetë në nivelin 20.84 €/MWh/h.




Arsyetim

- ZRRE me datë 11 tetor 2021, nga ndërmarrja NQ Termokos SH.A ka pranuar kërkesën për Amendamentimin - "Aneks Marrëveshjen për caktimin e çmimit të energjisë termike për furnizim me ngrohje", i cili është lidhur në mes KEK SH.A. – NQ Termokos SH.A., me datë 11 tetor 2021.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës dhe propozim ndryshimeve përmes Amendamentimin të Marrëveshjes për furnizim me ngrohje e lidhur në mes të KEK-Korporata Energjetike e Kosovës SH.A. dhe NQ Termokos SH.A, ka vlerësuar dhe kërkesa me ndryshime është e bazuar dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- III. Dispozitat tjera të Marrëveshjes bazë të nënshkruar me datën 15 dhjetor 2014 dhe aprovuar nga Bordi i ZRRE-së, me vendimin V_677_2014 të datës 23 dhjetor 2014 mbeten në fuqi.
- IV. Vendim nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.
- V. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i Rregullatorit:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Lutfije Dervishi, anëtare


Gani Bucaj, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

Palës, dhe
Arkivit të ZRRE-së.